

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm**

B1

ID Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË
TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 28/01/2023

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Cila nga opsionet e listuara mëposhtë pritet nga bordi i drejtorëve dhe zyrtarët e një korporate publike?
 - a) Detyrë e kujdesit të lehtë.
 - b) Detyra e kujdesit të zakonshëm.
 - c) Detyra e kujdesit maksimal.
 - d) Detyra e besnikërisë.

2. Cili nga opsionet si më poshtë NUK është një nga tre modelet e etikës së menaxhimit?
 - a) Menaxhimi imoral.
 - b) Menaxhimi moral.
 - c) Menaxhimi amoral.
 - d) Menaxhimi etik.

3. Vetë-sigurimi ndryshon nga krijimi i një fondi rezervë në atë që:
 - a) Krijimi i një fondi rezervë është një formë e mbajtjes së rrezikut.
 - b) Vetë-sigurimi përfshin parapagimin e humbjeve të pritshme përmes një fondi të krijuar posaçërisht për atë qëllim.
 - c) Vetë-sigurimi kërkon ekzistencën e një grupi të njëjësive të ekspozimit mjaft të mëdha për të lejuar parashikimin e saktë të humbjes.
 - d) Vetë-sigurimi kërkon formimin e një kompanie filiale.

4. Cila nga këto që vijon është funksioni themelor i qeverisjes së korporatave?
 - a) Sigurimi i strukturës dhe burimeve të organizatës
 - b) Vendosja e rregullave dhe procedurave
 - c) Monitorimi i vazhdueshëm i performancës së organizatës
 - d) Caktimi i të drejtave dhe përgjegjësisë për të gjithë punonjësit

5. Cila nga sa vijon adreson përgjegjësitë ekonomike, ligjore, etike dhe filantropike të një korporate?
 - a) Auditimi i kujdesit të duhur
 - b) Auditimi i etikës
 - c) Auditimi i qeverisjes
 - d) Auditimi social

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

RRUMBULLAKOSNI VETËM NJË PËRGJIGJE TË SAKTË!

Nga 2 pikë secila

6. Qeverisja e korporatës ka një ndikim të fuqishëm në aftësinë e korporatës që të:

- a) Mbijetojnë vazhdimisht
- b) Të ndihmoj në rritjen e firmës
- c) Të krijoj avantazh konkurrues
- d) Të performoj më mirë

7. Përgjegjësia sociale duhet të konsiderohet si një faktor, në cilën nga këto fusha?

- a) Planifikimin operacional
- b) Planifikimin strategjik
- c) Planifikimin funksional
- d) Planifikimin e njësisë së biznesit

8. Një mjet që në përgjithësi NUK përdoret për të menaxhuar rrezikun subjektiv është:

- a) Marrja e më shumë informatave
- b) Diskutim ne grup
- c) Identifikimi dhe analizimi sistematik i metodave të përshtatshme për trajtimin e rreziqeve
- d) Ulje e nivelit të ashpërsisë

9. Cila nga sa vijon paraqet më së miri analizën e ndikimit të biznesit si një mjet për menaxhimin e rrezikut?

- a) Kjo analizë përfshin caktimin e vlerësimeve të probabilitetit ndaj rezultateve alternative dhe përmbledhjen e produkteve të rezultateve të ndryshme
- b) Kjo analizë mund të zbatohet për çdo funksion të biznesit, operacion, ose mision dhe rezultatet pastaj integrohen në strategjitë e biznesit, planet, politikat dhe procedurat
- c) Kjo analizë kryhet pasi të identifikohen të gjitha kontrollet e mundshme dhe të vlerësohet fizibiliteti dhe efektiviteti i tyre për secilin kontroll të propozuar për të përcaktuar se cilat kontrolle kërkohen dhe të përshtatshme për rrethanat e tyre
- d) Kjo analizë tregon se sa do të ndodhë ndryshim në rezultate si përgjigje ndaj një ndryshimi të dhënë në inpute

10. Çmimi i naftës së papërpunuar për fuçi sot është 105€ dhe ekziston një probabilitet prej 25% që çmimi të rritet në 115€ në vitin e ardhshëm, një mundësi 25% që çmimi do të bjerë në 100€, dhe një mundësi 50% për një rritje të lehtë në 110€. Cila nga sa vijon është çmimi i ardhshëm i një fuçi naftë të papërpunuar duke përdorur një qasje me vlerë të pritshme dhe duke rrumbullakuar përgjigjen?

- a) 108€
- b) 109€
- c) 113€
- d) 115€

Metoda e vlerës së pritur përfshin caktimin e vlerësimeve të probabilitetit ndaj rezultateve alternative dhe përmbledhjen e produktit të rezultateve të ndryshme. $115€ \times 0.25 + 100€ \times 0.25 + 110€ \times 0.50 = 28,75€ + 25€ + 55€ = 108,75€ \sim 109€$

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

11. Menaxhimi i rrezikut ka të bëjë kryesisht me:

- a) Rreziqet dinamike
- b) Rreziqet e pastra
- c) Rreziqet spekulative
- d) Rreziqet themelore

12. Shmangia e rrezikut duhet të përdoret në ato raste në të cilat:

- a) Ashpërsia e humbjes është e lartë
- b) Ashpërsia dhe shpeshtësia e humbjes janë të larta
- c) Frekuenca e humbjes është e lartë
- d) Frekuenca ose ashpërsia nuk mund të përcaktohet

13. Lidhur me sigurinë e sistemit të informacionit, qëllimi i analizës së rrezikut është që të arrihet një:

- a) Balancë teknike midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse
- b) Balancë operacionale në mes ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse
- c) Balancë ekonomike në mes ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse
- d) Balancë ligjore midis ndikimit të rreziqeve dhe kostos së masave mbrojtëse

14. Nëse një kompani është përballur me një burim të kufizuar, cila nga sa vijon NUK është një zgjedhje e mundshme për lehtësimin e kufizimit?

- a) Rritja e kapacitetit të burimit të kufizuar
- b) Injorimi i kufizimit
- c) Ulja e përdorimit të burimit të kufizuar në prodhim
- d) Përqendrimi në produktet që kërkojnë më pak burim të kufizuar

15. Cila nga sa vijon është e përshtatshme për të zbuluar vonesat ose mundësit për gabime në përcjelljen e informacionit në mënyrën se si kryhen detyrat e zyrës dhe ato administrative?

- a) Analiza e procesit klerik
- b) Analiza e procesit të përbashkët
- c) Analiza e procesit të operatorit
- d) Analiza e procesit të produktit

16. Një proces jep vlerë përmes të gjitha pikave të mëposhtme përveç:

- a) Shitjes
- b) Kualitetit
- c) Uljes së kostos
- d) Fleksibilitetit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

17. Koha midis vendosjes së një porosie dhe asaj kur pranohet nga klienti njihet si:

- a) Koha e arritjes
- b) Koha e ciklit të porosisë
- c) Koha e transportit
- d) Koha e porositjes

18. Kostoja e mbajtjes së inventarit është e barabartë:

- a) Inventari mesatar në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
- b) Inventari mesatar në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
- c) Saldo përfundimtare e inventarit në Euro x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit
- d) Saldo përfundimtare e inventarit në njësi x çmimi i njësisë x kostoja mbajtëse në vit

19. Sa i përket teorisë së kufizimeve, cili nga sa vijon NUK është një shembull i një efekti të padëshirueshëm?

- a) Prodhim i tepërt
- b) Shumë stoqe
- c) Shumë urdhër-porosi që nuk dërgohen siç është planifikuar
- d) Shpejtimin i tepërt i urdhër-porositjes
- e) Koha e porositjes

20. Një sistem i planifikimit të kërkesave materiale (MRP) do të ishte më i vështirë të aplikohet për një prodhues i cili:

- a) Përdor relativisht pak materiale direkte
- b) Ka kohë të gjatë të strukturimit të pajisjeve prodhuese
- c) Është në një industri shumë të paqëndrueshme
- d) Përballon kosto të larta joproductive

21. Cilët nga faktorët strategjikë të mëposhtëm luajnë rol në përcaktimin e një çmimi bazë?

- I. Objektivat e kompanisë
- II. Strategjia e pozicionimit
- III. Strategjitë e reja të çmimeve të produkteve
- IV. Dallimet në cilësi dhe çmime

- a) I dhe II
- b) II dhe III
- c) III dhe IV
- d) I, II, III dhe IV

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

22. Kur nuk ka mbrojtje nga patenta mbi një produkt, firmat ndjekin një strategji çmimi që synon:
- Stabilizimin e çmimit dhe marzhit
 - Arrijtjen e një ROI të synuar
 - Një pjesë të tregut
 - Maksimizimin e fitimit
23. Gjatë trajtimit të palëve të ndërlidhura, cila nga sa vijon është lloji më i vështirë i transaksionit?
- Shitjet e raportuara gabim midis bashkëpunëtorëve
 - Transaksione të papërcaktuara ndër-komerciale
 - Kredi personale për shefin ekzekutiv aktual
 - Një anëtar i familjes së ngushtë që është aksionar kryesor
24. Cili nga sa vijon është qëllimi kryesor i komunikimit të aksionarëve dhe investitorëve?
- Ndershmëria
 - Konsistenca
 - Qartësia
 - Efektiviteti
25. Cili nga sa vijon NUK është një nga parimet e menaxhimit të përgjithshëm të cilësisë (TQM)?
- Bëni mirë herën e parë
 - Përpquni për zero defekte
 - Përqendrohuni tek klienti
 - Ndërtoni punë ekipore dhe fuqizim
26. Menaxhimi i përgjithshëm i cilësisë në një mjedis prodhimi ilustron më së miri nga:
- Identifikimi dhe përpunimi i defekteve të prodhimit përpara shitjes
 - Dizajnimi i produktit për të minimizuar defektet
 - Kryerja e inspektimeve për të izoluar defektet sa më shpejt që të jetë e mundur
 - Bërja e rregullimeve të makinerisë në mënyrë periodike për të zvogëluar defektet
27. Për shkak të numrit të madh të faktorëve që mund të ndikojnë në kërkesën për produktin e ri, bashkëveprimet midis këtyre faktorëve dhe mundësitë që lidhen me vlera të ndryshme të këtyre faktorëve, departamenti i marketingut do të dëshironte të zhvillonte një model të kompjuterizuar për projektimin e kërkesës për këtë produkt. Duke përdorur një procedurë të numrit të rastit për të gjeneruar vlera për faktorët e ndryshëm, do të jetë në gjendje të vlerësojë shpërndarjen e kërkesës për këtë produkt të ri. Kjo metodë e vlerësimit të shpërndarjes së kërkesës për produktin e ri quhet:
- Simulimi i Monte Carlos
 - Programimi linear
 - Analiza e korrelacionit
 - Analiza diferenciale

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

28. Një kompani është e shqetësuar që stoqet e pjesëve të këmbimit janë shumë të mëdha. Është përpjekur të mbajë në stoqe pjesët kritike të këmbimit në mënyrë që pajisjet të kenë kohë joproduktive minimale. Menaxhmenti dëshiron të dijë vlerën optimale të pjesëve të këmbimit në stoqe nëse vlerësohet se koha joproduktive kushton 150€ në ditë. Kostoja e mbajtjes dhe kostoja e porositjes nuk janë matur. Ju është kërkuar të bëni një rekomandim zyrtar për nivelet e rezervave të pjesëve të këmbimit. Identifikoni teknikën më të përshtatshme për këtë situatë.

- a) Hulumtimi i operacioneve
- b) Analiza e vlerës
- c) Lista e attributeve
- d) 'Stuhia e mendimeve' (barinstorming)

29. Mendimi grupor NUK ndodh kur:

- a) Ekspertët e jashtëm përdoren gjerësisht
- b) Jepet një optimizëm i tepërt
- c) Ekziston një dëshirë e fortë për unanimitet
- d) Ekziston një shtypje e mospërputhjes së mendimeve

30. Cila nga bazat e mëposhtme të pushtetit i referohet një personi që posedon dhe shpërndan informacion të vlefshëm për të tjerët që kanë nevojë për një informacion të tillë?

- a) Fuqia e shpërblimit
- b) Fuqia e ekspertit
- c) Fuqia legjitime
- d) Fuqia referuese

31. Gjatë cilës nga fazat e mëposhtme të zhvillimit të ekipit shfaqet uniteti i ekipit?

- a) Kryerjes
- b) Normimit
- c) Mësymjes
- d) Formimit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

32. Për disa vite, departamenti i auditimit të brendshëm kishte përdorur softuer të bazuar në karaktere në lloptopët e tyre për të kryer auditimet e caktuara. Pas kryerjes së një hulumtimi të gjerë, drejtori i departamentit të auditimit të brendshëm përcaktoi që një ndryshim në softuer me një ndërfaqe grafike të përdoruesit (GUI) do të ishte i dobishëm për departamentin. Kur tema u njoftua në një mbledhje të rregullt departamentesh, disa nga personeli i departamentit të auditimit të brendshëm shprehën shqetësimin për kohën shtesë që do të duhej për të mësuar softuer të ri, ngadalësinë e softuerit GUI dhe faktin që programi i bazuar në karakter ishte tashmë i njohur për ta dhe nuk kishte shkaktuar probleme. Cila nga qasjet e mëposhtme do të ishte më e përshtatshme për të ndryshuar qëndrimet e personelit të auditimit?

I. Informoni personelin e auditimit për hulumtimin e përfunduar

II. Impononi vendimin në personelin e auditimit

III. Ofroni pushime dhe fonde të departamenteve për trajnime

IV. Negocioni datat për prezantimin e softuerit

V. U thoni punonjësve që nëse nuk e pranojnë programin e ri, ata mund të pushohen

a) I, II, III dhe IV

b) I, III, IV

c) II, III, V

d) II, IV, V

33. Një auditor i brendshëm po kryen një rishikim operacional që prek disa njësi të ndryshme funksionale. Auditori beson se procesi në shqyrtim mund të përmirësohet, por menaxherët operues janë rezistentë ndaj sugjerimeve për ndryshim. Ekzistojnë disa metoda që auditori mund të përdorë për të kapërcyer rezistencën e menaxherëve operues. Identifikoni teknikën që do të ofroj probabilitetin më të lartë të suksesit me efektet më të pakta negative.

a) Negocimi me menaxherët operues

b) Pjesëmarrja nga menaxherët në procesin e vendimit

c) Detyrimi i menaxherëve përmes kërcënimeve

d) Bashkëpunim duke i' u drejtuar secilit menaxher individualisht

34. Auditorët e brendshëm mund të konsiderohen si agjentë kryesorë për ndryshime brenda një organizate. Cila nga sa vijon NUK është një mënyrë e mirë për të promovuar këtë koncept?

a) Një direktivë nga menaxhmenti i lartë, që thotë se auditorët e brendshëm do të përdoren për të gjitha projektet e përmirësimit të procesit

b) Një broshurë që përshkruan se çfarë mund të bëjë auditimi i brendshëm dhe kualifikimet e auditorëve

c) Pyetësorët pas auditimit për të marrë informacione se si auditorët perceptojnë operacionin e auditimit

d) Buletin që nxjerrë në pah aplikacione të përhapura ose universale të gjetjeve të auditimit

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Një nga pengesat në grafikun tradicionale Gantt të përdorur në menaxhimin e projekteve është se nuk paraqet grafikisht cilën nga sa vijon?

- a) Rendin e aktiviteteve
- b) Afatin kohor të aktiviteteve
- c) Marrëdhëniet e veprimtarive
- d) Strukturën e veprimtarive

36. Gjatë verifikimit biometrik, cili nga sa vijon mund të rezultojë në kohë më të shpejtë të reagimit të sistemit dhe mund të jetë më i kushtueshëm?

- a) Përputhjet një me një
- b) Përputhjet një me shumë
- c) Përputhjet shumë me një
- d) Përputhjet shumë me shumë

37. Cila nga sa vijon mund të kufizojë numrin e pikave të hyrjes në rrjet në një sistem informacioni që mundëson monitorimin e trafikut të rrjetit hyrës dhe dalës?

- a) Rruga e besuar
- b) Sistemi kompjuterik i besuar
- c) Baza e besueshme e llogaritjes
- d) Lidhje e besuar në internet

38. Ndryshimi i paautorizuar i regjistrave në internet mund të parandalohet duke përdorur:

- a) Verifikimin me çelës
- b) Kontrolllet e sekuencës kompjuterike
- c) Përputhja e kompjuterit
- d) Kontrolllet e hyrjes në bazën e të dhënave

39. Sistemet e aplikimit të bazës së të dhënave kanë ngjashmëri dhe ndryshime nga sistemet tradicionale të aplikimit të skedarëve të sheshtë. Sistemet e bazës së të dhënave ndryshojnë më së shumti në cilën nga fushat e mëposhtme të kontrollit?

- a) Integritetin referent
- b) Kontrolllet e hyrjes
- c) Redaktimin e të dhënave dhe rutinat e vlerësimit
- d) Rimëkëmbjen e të dhënave

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

40. Aksionet preferenciale dhe të zakonshme ndryshojnë në atë që:

- a) Dështimi për të paguar dividendët në aksione të zakonshme nuk do ta detyrojë firmën në falimentim ndërsa mos pagimi i dividendëve në aksionet preferenciale do ta detyrojë firmën në falimentim
- b) Dividendët e aksioneve të zakonshme janë në shumë fikse ndërsa dividendët e aksioneve preferenciale nuk janë
- c) Aksionet preferenciale kanë një përparësi më të lartë se aksionet e zakonshme në lidhje me fitimet dhe pasuritë në rast të falimentimit
- d) Dividendët e aksioneve preferenciale janë të zbritshëm si shpenzim për qëllime tatimore ndërsa dividendët e aksioneve të zakonshme nuk janë

41. Informacioni i pjesshëm i bilancit për një kompani për vitet që përfundojnë më 31 Dhjetor 2021 dhe 2022 janë:

	31.12.2022	31.12.2021
Pasuritë rrjedhëse (përveç parasë)		
Llogaritë rrjedhëse	€20,000	€5,000
Stoqet	€50,000	€14,000
Shpenzimet e parapaguara	€3,000	€6,000
Detyrimet rrjedhëse		
Llogaritë e pagueshme	€32,000	€16,000
Tatimi i pagueshëm në pronë	€4,000	€3,000

Kapitali punues u rritë në vitin 2022 me €12,000. Ndryshimi i parave të gatshme në vitin 2022 ishte:

- a) €12,000
- b) €43,000
- c) € (19,000)
- d) € (36,000)

Ndryshimi në para = Ndryshimi në kapitalin punues - Ndryshimi në pasuritë rrjedhëse jo-monetare + Ndryshimi në detyrimet rrjedhëse

Ndryshimi në para = 12,000 - (15,000 + 36,000 - 3,000) - (16,000 + 1,000) = - 19,000€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

42. Një kompani kishte 500 njësi në stoqet fillestare që kushtonin 5 € për njësi. Më 1 mars, kompania bleu 300 njësi me një kosto prej 7€ secila. Më 1 shtator u blenë edhe 300 njësi të tjera. Gjatë vitit u shitën 700 njësi dhe saldo përfundimtare e stokeve është €2,500. Nëse kompania përdor metodën (FIFO) të vlerësimit të stokeve, atëherë kostoja për njësi e artikujve të blerë në 1 shtator, në centin më të afërt, ishte:

- a) 3.67€
- b) 6.00€
- c) 6.67€
- d) 7.58€

$$2,500€ = 100\text{njs.} \times (7€) + 300\text{njs.} \times (\text{kosto e panjohur})$$

$$\text{Kosto e panjohur} = (2,500€ - 700€) / 300\text{njs.} = 6.00€$$

43. Një kompani raportoi një mospërputhje të rëndësishme të efikasitetit material për muajin Janar. Të gjitha sa vijojnë janë shpjegime të mundshme për këtë mospërputhje përveç:

- a) Prishje në mirëmbajtjen parandaluese
- b) Një forcë pune e trajnuar dhe e mbikëqyrur në mënyrë jo të duhur
- c) Përpunimi i një numri të madh të porosive të nxituar
- d) Prodhimi i më shumë njësive sesa ishte planifikuar në buxhet

44. Një nga avantazhet kryesore të buxhetimit është se:

- a) Nuk zë vendin e menaxhimit dhe administrimit
- b) Bazon planin e fitimit në vlerësime
- c) Adaptohet vazhdimisht për t'iu përshtatur rrethanave që ndryshojnë
- d) Kërkon nga menaxherët e departamenteve të bëjnë plane në përputhje me planet e departamenteve të tjera të ndërvarura

45. Një organizatë ofron kushtet e kreditit të klientëve të saj prej 5/10 neto 20. Një e treta e klientëve marrin zbritjen e parave të gatshme dhe klientët e tjerë paguajnë në ditën 20. Mesatarisht, 20 njësi shiten në ditë, me çmim €10,000 secila. Shkalla e shitjeve është uniforme gjatë gjithë vitit. Duke përdorur një vit me 360 ditë, organizata ka ditë shitje të papaguara, deri në ditën më të afërt të plotë, të:

- a) 13 ditë
- b) 15 ditë
- c) 17 ditë
- d) 20 ditë

Një - e treta e klientëve përfitojnë nga zbritja në para prej 5% dhe paguajnë në ditën 10. Dy të tretat e mbetura të klientëve paguajnë në ditën 20. Ditët mesatare të shitjeve të papaguara llogariten si:

$$\text{Ditët e shitjeve të papaguara} = (1/3) \times (10 \text{ ditë}) + (2/3) \times (20 \text{ ditë}) = 17 \text{ ditë}$$

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullakosni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

46. Kostot e organizimit të një biznesi, përfshirë tarifat e avokatëve dhe kontabilistëve duhet të jenë:

- a) Kapitalizuar, por jo amortizuar, për shkak të jetës së pacaktuar të biznesit
- b) Nuk janë regjistruar sepse ato janë shpenzime të organizuesit
- c) Kapitalizuar dhe amortizuar gjatë jetës së tyre të dobishme, për të mos kaluar më shumë se 40 vjet.
- d) Kapitalizuar dhe shtyhet deri në likuidimin e biznesit

47. Nëse zhvlerësimi ishte mbivlerësuar gabim materialisht në vitin paraprak, korrigjimi në vitin pasardhës kur zbulohet gabimi do të përfshijë:

- a) Rritjen e fitimeve të raportuara për vitin aktual
- b) Uljen e fitimeve të raportuara për vitin aktual
- c) Rritjen e bilancit fillestar të fitimeve të mbajtura për vitin aktual
- d) Zvogëlimin e bilancit fillestar të fitimeve të mbajtura për vitin aktual

48. Cila nga sa vijon NUK është një ndryshore në studimin ndërkombëtar të Hofstede për kultura të ndryshme?

- a) Distanca e fuqisë
- b) Orientimi politik
- c) Individualizmi-kolektivizmit
- d) Shmangia e pasigurisë

49. Sipas Michael Porter, kushtet që krijojnë avantazhe për firmat në disa vende dhe industri përfshijnë:

- I. Furnizuesit e një industrie të veçantë janë më të mirët në botë
- II. Ekziston një konkurrencë e fortë në industri
- III. Firma ka aftësinë të tërheqë menaxherët më të talentuar
- IV. Blerësit janë ndër më kërkuesit në botë

- a) I dhe II
- b) II dhe III
- c) III dhe IV
- d) I, II, III dhe IV

50. Nëse blerësi inspekton mallrat para lidhjes së kontratës, atëherë garancioni i nënkuptuar :

- a) Aplikohet ende
- b) Nuk do të jetë e zbatueshme në asnjë rrethanë
- c) Nuk aplikohet për defektet që janë të dukshme gjatë inspektimit të arsyeshëm
- d) Asnjë nga të mësipërmet